

MEG ALBANIA

Themeluar me 21.11.2008

**Pasqyrat Financiare individuale te shkurtuara (SKK 15)
per periudhen nga 01.01.2021 deri me 31.12.2021**

MEG ALBANIA SHPK**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

më 31 Dhjetor 2021

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
<u>Aktivet</u>		
Aktivet afatshkurtra		
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	819,589	1,280,615
Llogari të arkëtueshme	53,149,698	53,149,698
Llogari të tjera të arkëtueshme	4,660,355	4,766,921
Total i aktiveve afatshkurtra	58,629,642	59,197,234
Aktive afatgjata		
Aktive financiare		
Huadhenie afatgjate	46,060,000	46,060,000
Aktive afatgjata materiale	9,296,695	9,451,434
Totali i aktiveve afatgjata	55,356,695	55,511,434
Totali i aktiveve	113,986,337	114,708,669
Detyrimet dhe kapitali		
Detyrimet afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare	27,339,966	27,310,754
Detyrime të tjera afatshkurtra	11,684,987	11,689,415
Detyrime ndaj punonjesve	3,594,949	3,354,897
Detyrime ndaj shtetit	-	159,092
Totali i detyrimeve afatshkurtra	42,619,901	42,514,157
Detyrimet afatgjata		
Huamarrje afatgjata	38,353,380	38,454,650
Totali i detyrimeve afatgjata	38,353,380	38,454,650
Totali i detyrimeve	80,973,281	80,968,807
Kapitali		
Kapitali aksioner	100,000	100,000
Rezerva kapitali	126,775	126,775
Fitimet (humbjet) e akumuluar	33,513,087	34,266,491
Fitimi (humbja) e vitit	(726,805)	(753,404)
Totali i kapitalit	33,013,057	33,739,862
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	113,986,337	114,708,669

Këto pasqyra financiare janë miratuar në datën 26.03.2022 dhe janë nënshkruar nga:

MEG ALBANIA

Administratori

MEG ALBANIA SHPK**PASQYRA E PERFORMANCËS**

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2021</u>	<u>Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2020</u>
Të ardhura te tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit	-	-
Totali i të ardhurave	-	-
Shpenzime të personelit	(275,464)	(522,379)
Paga dhe shperblime	(46,004)	(447,629)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore	(154,740)	(74,750)
Amortizimet	(355,360)	(194,217)
Shpenzime të tjera	(831,568)	(37,131)
Totali i shpenzimeve	(275,464)	(753,727)
(Humbja)/Fitimi nga veprimtaria kryesore	(831,568)	(753,727)
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit	104,762	323
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare	104,762	323
Fitimi/(Humbja) para tatimit	(726,805)	(753,404)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (5%)		-
(Humbja)/Fitimi neto e vitit financiar	(726,805)	(753,404)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	(726,805)	(753,404)

SHENIMET SHPJEGUESE

MEG Albania SH.P.K

NUIS K89721201V

Shenime per Pasqyrat Financiare per periudhen e mbyllur me dt. 31.12.2021

A. Te pergjithshme

(a) Aktiviteti

Themeluar me 21.11.2008

(b) Standartet e kontabilitetit

Pasqyrat Financiare jane pergatitur ne perputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 15). Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike, përjashtuar derivativët financiar (n.q.s ka), instrumentat financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit e humbjes dhe aktivet financiare të vlefshme për shitje, të cilat maten me vlerë të drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare jane pasqyruar ne LEK e cila eshte monedha funksionale e kompanise.

(d) Përdorimi i gjykimeve dhe hamendësimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare konform SKK-ve, kërkon që manaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi dhe në cdo periudhë të ardhme që preket.

(e) Transaksionet ne monedha të huaja

Transaksionet në monedhat e huaja janë perkthyer me kursin e kembimit te datës së transaksionit. Aktivet monetare në monedha te huaja janë pekthyer në LEK me kursin ne ditën e mbylljes së bilancit. Diferencat e konvertimit si pasojë e përkthimit të monedhave te huaj në Leke janë përfshirë në fitim humbje. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj vlerësuar me koston historike, jane raportuar me kursin historik të monedhës së huaj në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhe te huaj te vlerësuar me vlerën e drejtë janë përkthyer në LEK me kursin e monedhës së huaj në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Kursi i kembimit i dates 31.12.2020 sipas BSH ka gene 1 EUR = 123.7 LEK

(f) Aktivet afatgjate materiale (AMM)

Toka, ndërtesa, makineritë e pajisjet maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe cdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Kosto përfshin shpenzimet që lidhen direkt me blejren e aktivit. Kur pjesë përbërëse të aktivit kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato mbahen si zëra të vecantë të aktiveve afatgjate materiale. Zhvlerësimi llogaritet mbi vlerën e zhvlerësueshme që është kosto e aktivit, ose ndonjë vlerë tjetër në vend të koston, minus vlerën e mbetur. Zhvlerësimi paraqitet në pasqyren e të ardhurave e shpenzimeve duke përdorur metodën Metoden e Vleres se mbetur sipas normave te meposhtme:

Ndertesa	5% (mbi vleren e mbetur)
Makineri paisje	20% (mbi vleren e mbetur)
Mjete transporti	20% (mbi vleren e mbetur)
Paisje kompjuterike	25% (mbi vleren e mbetur)
Paisje zyre dhe te tjera	20% (mbi vleren e mbetur)

(g) Inventari

Inventari perfaqeson vleren e materialeve te vleresuara me me te voglen midis kosos se blerjes dhe vleres neto te realizueshme sipas metodës se kosos mesatare te ponderuar e cila rakordon me inventaret fizike te kryera ne fund te vitit. Perfshihen edhe parapagimet e bera nga shoqeria per furnizime te periudhave te ardhshme.

(h) Provizionet për rreziqe

Provizionet per rreziqe pranohen kur kompania ka nje detyrim aktual (ligjor apo të pranuar tërthorazi), si rezultat i ndodhive në të kaluaren dhe ka gjasa qe permbushja e ketyre detyrimeve kerkon sakrifikimin e burimeve ne pronesi te kompanise te cilat do te sillnin perfitime ekonomike ne te ardhmen, dhe kompania ka mundesi të percaktoje besueshem vleren e ketyre rreziqeve.

(j) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesat per llogarite bankare, dhe perfitimet nga diferencat e kembimit. Interesat njihen ashtu siç perllogariten duke perdorur metoden e interesit efektiv. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet per interesa dhe humbjet nga diferencat e kembimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.